



Storje Sukses



Nga një kuzhinierë shtëpiake në pronare biznesi: Mundësimi i fuqizimit ekonomik të grave përmes trajnimeve joformale

Ofrimi i mundësive për gratë për të gjetur punë, duke përmirësuar sistemin e trajnimit joformal, është një nga qëllimet kryesore të projektit EYE (Rritja e Punësimit të të Rinjve). Për ta arritur këtë, Korabi Corporation krijoi Qendrën Inovative Korabi dhe trajnoi mbi 500 njerëz në artet e pastičerisë, ku pjesa më e madhe ishin gra dhe shumë prej të cilave kanë siguruar punë në pastičeri ose kanë hapur bizneset e tyre. Korabi është lider në tregun e Kosovës për shpërndarjen e përbërësve thelbësorë për furra buke dhe pastičeri.

Kjo është storja e Krenare Jasharit - Një nga të diplomuarit e trajnimit për pastičeri nga Qendra Inovative Korabi

Gjatë pandemisë, dashuria e sapozbuluar e Krenares për gatimin e bëri atë ta niste një biznes për gatimin e bakllavave nga shtëpia. Duke parë potencialin për fitim edhe nga ëmbëlsirat, ajo vendosi t'i zgjerojë aftësitë e saj duke u regjistruar në një program trajnimi për pastičeri në Qendrën Inovative Korabi, të cilin e gjeti rastësisht përmes një reklame në Facebook.



Fotografia 1. Krenare Jashari, themeluese dhe pronare e Pastičerisë 'New Cake'

Pas përfundimit të trajnimit dyjavor, Krenarja hapi pastičerinë e saj me emrin "New Cake" ku punon me motrën e burrit të saj. Për ta rritur më tej biznesin e saj, ajo më vonë punësoi një punonjëse me orar të plotë - një nënë të tre fëmijëve me përkushtim të madh, e cila vazhdon të ofrojë mbështetje të jashtëzakonshme për Krenaren dhe dyqanin.

Shërbimi i shkëlqyer i Krenares ndaj klientëve dhe aftësitë e shitjes i bënë ëmbëlsirat e saj një zgjedhje të famshme në mesin e klientëve në zonën e saj, duke krijuar një grup të madh klientësh të cilët kthehen për të porositur përsëri. Aktualisht, Krenarja shet tridhjetë deri në dyzet ëmbëlsira në javë tek restorantet lokale, Il Gusto dhe In Café (në Ferizaj), dhe pranon porosi private përmes telefonit dhe rrjeteve sociale.

Krenarja aktualisht po përballet me sfida në realizimin e fitimit për shkak të inflacionit. Megjithatë të ardhurat e saj luhaten me ndryshimin e stinëve, ajo mund ta punësojë një person shtesë me orar të pjesshëm gjatë verës për ta ndihmuar me rritjen e porosive.





Familja e saj gëzon stabilitet financiar, por ajo gjithmonë e shtyn veten drejt përmirësimit. Biznesi i Krenares me ëmbëlsira i dha asaj pavarësi financiare dhe i mundësoi asaj shpesh që t'ia plotësonte nevojat fëmijëve të saj. Krenarja e këshillon këdo që mendon ta hapë një pastiçeri të tregohet i guximshëm dhe ta bëjë këtë. Ajo sugjeroi që të ndiqet modeli e saj duke filluar nga shtëpia, duke krijuar një grup klientësh dhe më vonë me hapjen e një dyqani ku mund të punësohet staf shtesë.

Këmbëngulja e Krenares na tregon se gjithçka është e mundur me mendësinë e duhur dhe përpjekje. Suksesi i saj është një burim frymëzimi për të gjitha gratë që mendojnë të fillojnë bizneset e tyre dhe të arrijnë pavarësi financiare. Shpresojmë që storja e Krenares të inkurajojë më shumë gra në vendin tonë që ta bëjnë hapin dhe t'i ndjekin ëndrrat e tyre, ashtu siç bëri ajo. Duke fuqizuar gratë ekonomikisht, ne mund ta përmirësojmë jo vetëm jetën e grave, por edhe të familjeve të tyre dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendit tonë.

Storja e Krenares është një dëshmi e efektivitetit të nismës EYE, pasi ajo mundi ta shndërronte pasionin e saj për gatimin në një biznes të suksesshëm. Prandaj, projekti EYE do të vazhdojë të mbështesë biznese të tilla si Korabi Corporation, të cilët janë të përkushtuar që storjet e suksesit si ajo e Krenares të bëhen realitet.



Fotografia 2. Pestiçeria 'New Cake', Ferizaj. Shkurt 2023

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes projektit të saj Përmirësimi i Punësimit të të Rinjve, të zbatuar nga Helvetas Kosova dhe MDA. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e projektit "Përmirësimi i punësimit të të rinjve" dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC-së.